



VENDIMI ëSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROSEVAC



Më  
Dana

02 - 07 2018

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Numri i lëndës: 2018:012374

Datë: 25.05.2018

Numri i dokumentit: 00045553

1

P.nr.2724 /2017

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues, Elmaz Zenuni, me sekretaren juridike -praktikatën Liridona Mehmeti në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED] [REDACTED] 'pa nr., për shkak të vepres penale nrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.2126-5/2016 të dt.27.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 23.04.2018,dhe shqyrtimi i dytë i dt.25.05.2018 në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit,Bahri Hyseni, të pandehurit, në të njejtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari, [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED] 'pa nr., i lindur me [REDACTED] në fshatin [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e eëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka të kryer shkollën e mesme,puntor në Servis të gjeneratorëve,i martuar babai I 5 (pesë) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,-

## ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 03.01.2016, rrëth orës 23:00, në Rrugën Gursel e Bajram Sylejmani në Ferizaj në drejtim të fshatit Varosh, I pandehuri duke drejtuar automjetin e markës "Audi Q5" me ngjzrë të bardhë, me targa të regjistrimit [REDAKTUE], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nen.46. të LSKRR-së nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurin e tyre për shkak të mos respektimit të përparësisë së kalimit të automjeteve në rrugën kryesore, fillon të kyqet në rrugën kryesore nga parkingu i auto servisit [REDAKTUE] dhe goditet me pjesën e përparme nga ana e majtë e automjetit VW Golf me targa të regjistrimit [REDAKTUE] me ngjyrë hiri, i cili qarkullonte rrugës kryesore, të cilën e drejtonte e dëmtuara [REDAKTUE], ku pos dëmeve material lëndim të lehta trupore pëson e dëmtuara [REDAKTUE], të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të dates 03.10.2017.

**Me këte ka kryer vepren penale rrezikimi i trafikut publik nga nen 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së .**

Andaj, Gjykata, në kuptim të nenit 378 par.6 të KPRK-së, dhe neneve 4,7, 8 par.1, 9,10 par.1,17 par.1, 21 par.1 dhe 2, 41, 42 par.1 nënpar.1.1, 43 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3, 45, 46, 47, 73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 365, 366 , 450 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurin e :

## GJYKON

Denohet me DENIM ME ME GJOBË në shumën prej 150 eurove (me shkronja: njëqin e pesëdhjet euro), të cilin gjobë i pandehuri do ta paguaj pasi i që aktgjyktimi të merr formën e prerë.

Nëse i denuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i akuzuari do ta vuaj denimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të denimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjyktimi.

E dëmtuara [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajit, për realizimin e kërkesës pasuror juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe pashallit gjyqësor të paguan shumën prej 80.88 € në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimtit –Ligi nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimtit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

#### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/II nr.2126-5/2016 të dt.27.10.2017, [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED] pa nr., për shkak të vepres penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së .

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së PTH-së, me datën 23.04.2018, mbajti shqyrtimin fillestardhë me dt.25.05.2018 mbajti shqyrtimin e dytë ku prezentuan prokurori i shtetit Bahri Hyseni , i pandehuri e e dëmtuara [REDACTED]

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestardhë dhe të dytë përkitazi me pranimin e fajsisë se konform nenit 248 par.5 të KPPRK-së ka të drejtë edhe në këtë faze ta pranoj veprën penale, i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimit të fajsisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, përkitazi me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit, është pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht,
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe ate: Ekspertiza mjeko ligjore e dt.03.10..2017, Ekspertiza e Komunikacionit e dt.09.10.2017,
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkizazi me të drejtën e ankesës vetëm për sankcionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

I akuzuari [REDACTED] në shqyrtimin fillestar në fjalën e tij në kuptim të mbrojtjes ka deklaruar, pasi e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që e ngarkon prokuroria është penduar

thellë për atë që e ka kryer, por thekson se nuk ka mundur ti kontrolloj veprimet e veta në atë moment, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale, kërkon falje për këtë veprim të vetin është i pa martuar jeton nga të ardhuratqë i realizon në autolarje dhe i ka propozuar gjykates që me rastin e matjes së denimit si rrethana letësuese ti ketë theksësimet e sipër thekësuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë egzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale rrëzikimi i trafikut public nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së .

*( Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajtit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr. 207/13 të dt.19.03.2013).*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se i pandehuri ka pranuar fajsinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të ketë qenë e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, pendesën per vepren e kryer, ka kërkuar falje për veprimet e ndërrmarrura , i martuar me 5 fëmijë varet nga puna e tij që mba edhe anëtarët e tjerë të familjes , i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, duke qenë e bindur se ne rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet, dhe një dënim i tillë është në proporcione peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrethanave të kryerjes.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave duke i caktuar denim më të butë dhe ate denim me gjobë në lartësi prej 150 eurove.

Nëse i denuari nuk e paguan gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, i akuzuari do ta vuaj denimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të denimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Mbështetur në nenin 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 80.88 €, i cili është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të të akuzuarit, dhe çështjen penale të zhvilluar.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimtit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimtit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së e dëmtuara [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajit. për realizimin e kërkesës pasuror juridike udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasuror juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2018:012374  
Datë: 25.05.2018  
Numri i dokumentit: 00045553

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,**  
**P.nr.2724/2017 të dt25.05.2018**

**Zyrtaja ligjore**

Liridona Mehmeti

**Gjyqtari**

Elmaz Zenuni



**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.